



MM - 430 MORTAR 10



PAKETIMI

25 kg



RAPORTI I PERZIERJES

5-6 L / 25kg



KONSUMI

12.5 kg/m²

Përshkrimi

MM-430 MORTAR 10 është një llaç për suvatimin e muraturave dhe tavaneve me qeramike, beton, ose cdo materiali tjetër me baze cimento.

Veçoritë

- Ka fuqi të lartë ngjitëse.
- Ka rezistencë të lartë mekanike.
- Rezistent ndaj cikleve të ngrirje-shkrirjes.
- Kursen kohë dhe punë.
- Lehtësisht i punueshëm.

Aplikimi

-Zbrazni me ngadalë 25 kg MM-430 MORTAR 10 në sasinë e rekomanduar të ujit dhe përziejeni derisa të përftohet një masë homogjene. Përzierja duhet bërë me një mikser me xhiro të ulëta. Mos shtoni asnjë aditiv (lëndë shtesë) që nuk është i shkruar në udhëzimin e përdorimit të produktit.

-Llaçi i përgatitur duhet të pushojë për 5-10 minuta që të bëhet gati për përdorim. Duhet përzierë sërish 1-2 minuta përpara se të aplikohet.

Mbrojtja pas Aplikimit & Sugjerime

- Llaçi i përgatitur duhet përdorur brenda 3 orëve. Llaçi i skaduar apo që ka zënë cipë në enë duhet hedhur. Kushtet e motit si temperatura e lartë, lagështia e ulët ose era mund ta shkurtojnë kohën e përdorimit.
- Pas aplikimit, duart dhe mjetet e punës duhen larë me ujë të bollshëm.
- Konsumi i treguar është informacion i përgjithshëm. Mund të ndryshojë në varësi të kushteve të aplikimit dhe veçorive të sipërfaqes.
- Përmban çimento, ndaj është irritues për sytë, sistemin e frymëmarrjes dhe lëkurën. Për më shumë informacione, referojuni fletës së të dhënave të sigurisë.

Magazinimi

- Produkti duhet ruajtur në ambient të thatë dhe të freskët, në temperature midis +5°C dhe +35°C, në kushte jo të lagështa dhe duke shmangur dritën direkte të diellit.
- Produkti duhet mbrojtur nga uji, ngrica dhe kushtet jo të favorshme të motit.
- Mund të vendosen deri në 3 paleta njëra mbi tjetrën.
- Jetëgjatësia është maksimalisht 12 muaj në kushtet e përshkuara më sipër për ruajtjen dhe magazinimin.

SKEDA TEKNIKE (NË +23°C DHE 50% U.R.)

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri
Magazinimi	12 muaj nëse ruhet në paketimin original të mbyllur, në një vend të thatë.
Raporti i përzierjes	5-6 litra ujë / 25 kilogram
Temperatura e aplikimit	(+5°C) - (+35°C)
Masa vëllimore e llacit të njome (EN 1015-6)	1800kg/m ³
Masa vëllimore e llacit të njome (EN 1015-10)	1600kg/m ³
Trashësia minimale e aplikimit për mure	Deri në 10mm
Trashësia minimale e aplikimit për tavane	Deri në 7-8mm
Rezistenca në ngjeshje (EN 1015-11)	5 N/mm ²
Rezistenca në perkulje (EN 1015-11)	1.2 N/mm ²
Reaksioni ndaj zjarrit (EN 13501)	Klas A1
Absorbimi I ujit (EN 998-1)	W0